



Qendra
Maqedonase për
Bashkëpunim
Ndërkombëtar

SHPALLJE

për paraqitje për pjesëmarrje në trajnim

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) si organizatë e cila siguron arsimim joformal ofron mundësi për pjesëmarrje në trajnime, të cilat do të organizohen në periudhën tetor-dhjetor 2007.

TRAJNIME PËR PERIUDHËN TETOR-DHJETOR 2007

TRAJNIMI	KOHËZGATJA	TERMINI I MBAJTJES SË TRAJNIMIT	AFATI PËR PARAQITJE	LOKACIONI	PJESËMARRJA FINANCIARE* PËR TRAJNIMIN (DENARË)	PJESËMARRJA FINANCIARE ME SHPENZIME DITORE** (DENARË)	PJESËMARRJA FINANCIARE ME SHPENZIME DITORE PËR ANËTARË TË ORGANIZATAVE QYTETARE*** (DENARË)
1 Menaxhment i avancuar	2 muaj	5 tetor – 4 dhjetor	25 shtator	Shkup, QMBN	15.500	/	5.000
2 Menaxhmenti organizativ dhe zhvillimi (në gjuhën shqipe)	5 ditë	1 – 5 tetor	20 shtator	Mavrovë, Hotel Bistra	8.300	19.000	2.850
3 Udhëheqja e integruar me ciklin e projektit	6 ditë (2 pjesë)	26 – 28 tetor; 2 - 4 nëntor	6 tetor	Shkup, QMBN	7.150	18.200	2.730
4 Udhëheqja me ciklin e projektit – indikatorët	4 ditë	29 nëntor - 2 dhjetor	20 tetor	Veles, Hotel Romantik	5.400	16.450	2.470
5 Udhëheqja me resurse njerëzore	4 ditë	15 – 18 dhjetor	27 nëntor	Mavrovë, Hotel Bistra	5.400	16.450	2.470

*Pjesëmarrja – i përfshin shpenzimet për trajnuesin, materialet e publikuara për trajnim dhe kafe pushim gjatë trajnimit.

**Shpenzime ditore të trajnimit – përfshin vendosjen në pension të plotë gjatë trajnimit.

***Çmimi për anëtarë të organizatave qytetare – ka të bëjë vetëm për kandidatët të cilët janë përfaqësues të organizatave qytetare, të regjistruara sipas Ligjit për shoqata të qytetarëve dhe fondacioneve, si dhe forma të tjera të shoqërimit (sindikata, oda, bashkësi fetare e tjera).

Trajnimet e ofruara janë zhvilluar në bashkëpunim me Menaxhmentin për fondacione zhvillimore – Holandë (MDF), ndërsa janë plotësisht të përshtatura në kontekstin lokal. Metodologjia e trajnimit është bazuar në të mësuarit me pjesëmarrje (ciklin e të mësuarit të riturit) dhe është përqendruar në shkëmbimin e përvojave dhe aplikimi i tyre në praktikë. Trajnimi aplikon vegla interaktive, ndërsa komponentë të rëndësishme e trajnimeve është puna praktike në probleme konkrete nga puna e pjesëmarrësve. Secili nga trajnimet zhvillohet në grupe, më së shumti 20 pjesëmarrës nga 2 trajnues me përvojë shumë vjeçare në fushën adekuate. Trajnimet zhvillohen në gjuhën maqedonase. Materialet e publikuara janë siguruar për çdo pjesëmarrës.

UDHËHEQJA E INTEGRUAR ME CIKLIN E PROJEKTIT

Kujt i dedikohet trajnimi

Trajnimi Udhëheqja me ciklin e projektit kryesisht është për personelin (dhe aktivistë) të organizatave, të cilat janë inkuadruar në zhvillimin, zbatimin dhe koordinimin e projekteve zhvillimore. Për ato organizata të cilat tani dëshirojnë të vendosin sistem të udhëheqjes me projekte (ciklin e projekteve), si dhe përdorimi i kornizës logjike në organizatat e tyre, rekomandohet pjesëmarrja e udhëheqësish së këtyre organizatave.

Qëllimi i trajnimit

Udhëheqja me ciklin e projektit (UCP) është trajnim i cili ka për qëllim t'ju mundësojë udhëheqje të mirë dhe facilitim me portfolion e projekteve ose programeve në organizatë.

UCP është kombinim i qasjes, i cili është përqendruar në tre çështje kryesore: krijimi i mirëkuptimit të përbashkët të proceseve; konceptet dhe kriteret për miratimin e vendimeve; krijimin e ndjenjës së pronësisë dhe përkushtimit të palëve të inkuadruara; si dhe përmirësimi i kapaciteteve për të mësuar të organizatës së inkuadruar.

Instrumenti kryesor që përdoret është Korniza logjike, e cila jo vetëm që do t'ju mundësojë formulim më të mirë dhe vlerësim të intervenimeve individuale, por do t'ju mundësojë edhe vëzhgim efektiv dhe vlerësim gjatë zbatimit.

Përdorimi i procedurave administrative, aplikimi i sistemit për udhëheqje me ciklin e projektit, si dhe instrumentet vetëm do ta rrisin efektivitetin në komunikacionin mes palëve të prekura, e kjo do të shpie drejt rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të organizatës suaj.

Përmbajtja e trajnimit:

- ▶ Udhëheqje me ciklin e projektit (UCP) – përqendrim në fazat e ciklit të projektit;
- ▶ Metodologjia e identifikimit dhe zgjidhja e problemeve – PPOQ (Planifikimi projektor i orientuar drejt qëllimeve);
- ▶ Analiza e problemeve (diagrami i problemeve);
- ▶ Analiza e qëllimeve (diagrami i qëllimeve);
- ▶ Zgjedhja e strategjisë për intervenim dhe korniza logjike (KL);
- ▶ Identifikimi i faktorëve të jashtëm të rëndësishëm për projektin – parakushte dhe supozime;
- ▶ Definimi i indikatorëve;
- ▶ Alocimi i resurseve dhe buxhetimi;
- ▶ Vëzhgimi (monitoringu);
- ▶ Vlerësimi (evoluimi);

MENAXHMENTI ORGANIZATIV DHE ZHVILLIMI

Kujt i dedikohet trajnimi

Trajnimi për menaxhment organizativ dhe zhvillim është i dedikuar për menaxherët modern, të cilët janë të vetëdijshëm për ndryshimet dhe nxitjet në rrethimin dhe kanë qëllim ta zhvillojnë organizatën e tyre. Më së miri është të marrin pjesë udhëheqës të organizatës (drejtorë, udhëheqës, anëtarë të këshillave drejtuese) të cilët janë inkuadruar në krijimin e politikave, strategjive dhe vendimeve strategjike në organizatën tuaj.

Qëllimi i trajnimit

Trajnimi për menaxhment organizativ dhe zhvillim do t'ju mundësojë të fitoni njohuri dhe shkathtësi të cilat janë të domosdoshme për udhëheqjen me organizatën, ndryshimet

organizative dhe zhvillimin.

Trajnimi ka për qëllim që ta forconi vetëdijen për rëndësinë e vendosjes së organizimit adekuat të brendshëm, që në mënyrë adekuate do t'ju përgjigjet nxitjeve të cilat i sjellin ndryshimet në rrethimin.

Gjatë trajnimit do të fitoni njohuri për kompletin e përgjithshëm të veglave të cilat përdoren për analizë të organizatës dhe kontekstit në të cilën funksionon organizata. Gjatë trajnimit do të mund të praktikoni vlerësim të organizatës dhe të mësoni si vendoset për prioritetet e saja strategjike. Qasja strukturore e trajnimit, më tej, do t'ju shpie në zhvillimin e strategjive për ndryshimet organizative dhe implikimet e tyre mbi personelin dhe organizatën në tërësi.

Përmbajtja e trajnimit

- ▶ Analiza institucionale: analiza e faktorëve të jashtëm dhe analiza e aktorëve në fushën e veprimtimit
- ▶ Analiza organizative
- ▶ Modeli organizativ i integruar
- ▶ Orientimi strategjik
- ▶ Korniza logjike
- ▶ Struktura organizative
- ▶ Sistemet dhe procedurat
- ▶ Stili i menaxhmentit dhe motivimi i personelit
- ▶ Kultura organizative
- ▶ Të mësuarit organizativ

UDHËHEQJA ME CIKLIN E PROJEKTIT - INDIKATORËT

Kujt i dedikohet trajnimi

Ky trajnim i dedikohet bashkëpunëtorëve të projekteve, këshilltarëve dhe nëpunësve të inkuadruar në zhvillimin dhe/ose vlerësimin e indikatorëve për nevojat e menaxhmentit kontrollit. Për këtë lloj të trajnimit është e nevojshme që pjesëmarrësit paraprakisht të njohohen dhe ta zotërojnë qasjen në kornizën logjike dhe procesin e planifikimit, vëzhgimit dhe vlerësimit.

Qëllimi i trajnimit

Indikatorët mund të jenë instrument kyç për udhëheqësit në udhëheqjen e projekteve dhe programeve zhvillimore.

Ky trajnim ofron mundësi që t'i kuptoni funksionet dhe kufizimet e indikatorëve; të jeni të përgatitur të zhvilloni dhe t'i njihni indikatorët tuaj për rrethimin dhe analizën organizative me qëllim

që të kontribuoni në planifikimin, vëzhgimin dhe vlerësimin më të mirë.

Trajnimi do t'ju mundësojë që t'i zvogëloni vështirësitë tuaja rreth gjetjes së indikatorëve adekuat dhe të dobishëm, me qëllim që t'i tejkaloni sistemet e mëdha dhe të shtrenjta për grumbullimin e të dhënave.

Përmbajtja e trajnimit

- ▶ Koncepte dhe indikatorë në jetën e përditshme;
- ▶ Analizë të kontekstit nëpërmjet indikatorëve;
- ▶ Indikatorë për analizën organizative;
- ▶ Indikatorë të planifikuar dhe SMART;
- ▶ Indikatorë për vëzhgim;
- ▶ Indikatorët kyç për vlerësim;
- ▶ SPICED indikatorët për matjen e ndikimit

LAJMËRIM PËR VITIN 2008

Në muajt e parë të vitit 2008 do të organizohen këto trajnime:

NR.	EMRI I TRAJNIMIT	PERIUDHA	KOHËZGATJA
1.	Menaxhmenti organizativ dhe zhvillimi	Janar	4 ditë, 15 sesione
2.	Udhëheqje me program	Shkurt	6 ditë, 23 sesione
3.	Menaxhment financiar për menaxherë jofinanciar	Mars	4 ditë, 15 sesione
4.	Marrëdhëniet me opinionion	Prill	4 ditë, 15 sesione

UDHËHEQJA ME RESURSE NJERËZORE

Kujt i dedikohet trajnimi

Trajnimi i dedikohet menaxherëve të cilët dëshirojnë t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre për udhëheqje me ciklin e projektit, si dhe për ata të cilët në organizatë janë të angazhuar që ta udhëheqin procesin dhe procedurat për udhëheqjen me resurset njerëzore.

Qëllimi i trajnimit

Trajnimi "Udhëheqje me resurse njerëzore" do t'ju mundësojë të fitoni njohuri për sistemin, procesin dhe veglat për udhëheqje me resurse njerëzore.

Trajnimi ka për qëllim që t'i përforcojë shkathtësitë ndër personale për udhëheqje efektive me resurset njerëzore dhe të sigurojë vegla për zhvillimin e resurseve njerëzore në organizatat tuaja.

Përmbajtja e trajnimit

- ▶ Sistemi për udhëheqje me resurset njerëzore
- ▶ Rekrutimi i personelit
- ▶ Zhvillimi i personelit
- ▶ Ndjekja e performansave të personelit
- ▶ Sistemi për shpërblimin dhe motivimin e personelit

MENAXHMENTI I AVANCUAR



Kujt i dedikohet trajnimi

Trajnimi i dedikohet liderëve të organizatave, menaxherëve me përvojë të caktuar në funksione udhëheqëse të cilët dëshirojnë t'i përmirësojnë shkathtësitë për udhëheqje.

Qëllimi i trajnimit

Suksesi i një kompanie është e lidhur drejtpërdrejt me aftësinë e menaxherëve të saj që ta nxitin më të mirën te secili i punësuar, ta nxjerrin maksimumin nga ekipi si tërësi, në kohë t'i shohin kërcënimet në rrethimin dhe të aplikojnë qasje adekuate për aftësimin organizativ dhe ndryshimet.

Qëllimi i programit është ta rrisë kuptimin e pjesëmarrësve për rolin e menaxherit dhe shkathtësitë e tij, ta përmirësojë aftësinë e menaxherëve për motivimin dhe zhvillimin e anëtarëve të ekipit, ta përmirësojë vetëdijen e tyre, vetëbesimin dhe shkathtësitë e menaxherëve dhe t'i aftësojë që të përdorin vegla dhe teknika menaxhmenti për miratimin e vendimeve dhe ndërtimin e ekipit efektiv.

Përmbajtja e trajnimit

Udhëheqja dhe drejtimi me organizatën;

PARAQITJA:

Fletëparaqitjet për secilën nga trajnimet mund të merren në zyrat e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar,

rr: Nikolla Parapunov p.n., kompleksi Makoteks - Televizioni i vjetër ose në veb faqen www.mcms.org.mk

Personi për kontakt: Afrodita Musliu
Tel. 02/3065-381
e-mail: ams@mcms.org.mk

Numeri i pjesëmarrësve për trajnime është i kufizuar. Gjatë zgjedhjes së pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë do të mbahet llogari për mbulimin e balancuar të grupeve të marginalizuara (gra, bashkësitë etnike, personat me nevojë të posaçme etj.) si dhe përfshirja gjeografike.

Udhëheqësi

- ▶ Ndërtimi i ekipit;
- ▶ Faktorët që ndikojnë në punën efektive të ekipit;
- ▶ Teoritë për udhëheqësin
- ▶ Stilet e udhëheqësish
- ▶ Dallimet mes udhëheqësit dhe menaxherit
- ▶ Vlerësimi i menaxhmentit dhe shkathtësive

Shkathtësitë udhëheqëse

- ▶ Të menduarit strategjik
- ▶ Drejtimi me ndryshimet dhe udhëheqja e kompanisë që mëson
- ▶ Shkathtësitë komunikative dhe dhënia e fidbekut
- ▶ Metodot për delegim
- ▶ Udhëheqja me pritjet divergjente
- ▶ Ndërtimi i besimit
- ▶ Shkathtësitë prezantuese
- ▶ Shkathtësitë negociuese

Miratimi i vendimeve

- ▶ Shkathtësitë facilituese dhe udhëheqja efektive e mbledhjeve
- ▶ Miratimi grupor i vendimeve
- ▶ Inkurajimi i pjesëmarrjes së të punësuarve
- ▶ Veglat për miratimin e vendimeve të bazuara në informata dhe analiza: SWOT, PERT, cost benefit analiza, matrica e bashkëpunimit etj.
- ▶ Kultura organizative dhe të mësuarit organizativ.

Vërejtje: Trajnimi do të realizohet nga ana e trajnuesve të njohur në fushën e menaxhmentit, si dhe menaxherë me përvojë në fusha të ndryshme nga Maqedonia dhe nga rajoni.